



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.42

22 prill

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 401 datë 24.3.2011	Për ratifikimin e shtesës së nenit 24 të Kartës së Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ)	1797
Ligj nr.10 402 datë 24.3.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Singaporit për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat”	1798
Ligj nr.10 405 datë 24.3.2011	Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve	1813
Vendim i Kuvendit nr.93, datë 7.4.2011	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.228, datë 29.1.2009 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”	1815
Rezolutë e Kuvendit datë 7.4. 2011	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2010	1818
Kërkesë e MPPT nr.1128/2, datë 8.3.2011	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkozet-Durrës-Shkozet (zona e Kënetës).....	1819
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Neriman Karagjozi	1821

LIGJ
Nr.10 401, datë 24.3.2011

**PËR RATIFIKIMIN E SHITESËS SË NENIT 24 TË KARTËS SË ORGANIZATËS SË
BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI (BEDZ)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet shtesa e nenit 24 të Kartës së Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ), bërë më 25 qershor 2004, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6965, datë 12.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Stamboll, 25 qershor 2004
BS/SFM/R (2004) 1

RAPORT

**I TAKIMIT SPECIAL TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME TË
SHTETEVE ANËTARE TË ORGANIZATËS SË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT
TË ZI (BEDZ)**

Stamboll, selia qendrore e BRDZ, 25 qershor 2004
(Ekstrakt)

**NEVOJA E REFORMAVE PËR RRRITJEN E EFEKTIVITETIT TË ORGANIZATËS, DUKE
PËRFSHIRË ZGJERIMIN E STAFIT DREJTUES TË SEKRETARIATIT TË PËRHERSHËM
NDËRKOMBËTAR TË BEDZ-IT (NËPËRMJET SHTIMIT TË POSTIT TË
ZËVENDËSSEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM, ME KANDIDATURË TË PROPOZUAR NGA
DELEGACIONI RUS)**

6. Këshilli vendosi si më poshtë:
3. Në kartën e BEDZ-it të shtohet neni i ri 24:

“Neni 24

Qendra Ndërkombëtare e Studimeve të Detit të Zi

Qendra Ndërkombëtare e Studimeve të Detit të Zi (QNSDZ) është organizatë me karakter ndërkombëtar që vepron si institut kërkimor i organizatës së BEDZ-it; ajo drejtohet nga një bord drejtorësh, anëtarët e të cilit janë shtetas të vendeve anëtare të BEDZ-it.

Qëllimet kryesore të QNSDZ-së janë studimi i rrugëve praktike të zgjerimit dhe thellimit të bashkëpunimit rajonal ndërmjet shteteve anëtare të BEDZ-it, marrëdhënieve BEDZ-BE dhe promovimi i arritjeve të shkencës dhe teknologjisë në fusha konkrete të bashkëpunimit shumëpalësh, mbështetur në parimet e kësaj karte dhe përparësive të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave të Punëve të Jashtme”.

Vërtetohet se ky ekstrakt është nxjerrë nga kopja origjinale e depozituar në Sekretariatën e Përhershëm të BEDZ-it.

LIGJ
Nr.10 402, datë 24.3.2011

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SINGAPORIT PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL, NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Singaporit për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6966, datë 12.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SINGAPORIT PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË
DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË
ARDHURAT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Singaporit:
me dëshirën për të lidhur një marrëveshje për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe
parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat;
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Personat e përfshirë

Kjo marrëveshje do të zbatohet për persona, të cilët janë rezidentë të një ose të dy shteteve kontraktuese.

Neni 2
Tatimet e përfshira

1. Kjo marrëveshje do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat, të vëna në emër të një shteti kontraktues ose të nënndarjeve politike apo autoriteteve të tij lokale, pavarësisht nga mënyra në të cilën ato vilen.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat të gjitha tatimet e vëna mbi të ardhurat totale ose elemente të të ardhurave, duke përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet marrëveshja, në veçanti janë:

a) në rastin e Shqipërisë:

- tatimet e të ardhurave (duke përfshirë tatimet e përfitimeve të korporatës dhe tatimet mbi të ardhurat individuale dhe tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël);
(në vijim referuar si “tatimet e Shqipërisë”)

b) në rastin e Singaporit:

- tatimet mbi të ardhurat

(në vijim të referuara si “tatimi i Singaporit”).

4. Marrëveshja zbatohet gjithashtu për çdo tatim të njëjtë ose në thelb të ngjashëm që është vendosur pas datës së nënshkrimit të marrëveshjes, si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën në lidhje me çdo ndryshim thelbësor që është bërë në ligjet e tyre përkatëse mbi tatimet.

Neni 3
Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) Termat “një shtet kontraktues” dhe “shteti tjetër kontraktues” është Shqipëria ose Singapori, siç e kërkon konteksti.

b) Termi “Shqipëri” nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila sipas ligjeve të saj dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë, brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore.

c) Termi “Singapor” është Republika e Singaporit dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, termi “Singapor” përfshin ujërat territoriale të Singaporit dhe çdo zonë të shtrirë tej kufijve të ujërave territoriale të Singaporit, shtratin detar dhe nëntokën e çdo zone të tillë, që është caktuar ose mund të caktohet pas kësaj sipas ligjeve të Singaporit dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare si një zonë mbi të cilën Singapori ka të drejtat sovrane për qëllimet e kërkimit dhe të shfrytëzimit të burimeve natyrore, të gjalla ose jo të gjalla.

d) Termi “person” nënkupton një individ, shoqëri dhe çdo grup tjetër personash.

e) Termi “shoqëri” nënkupton çdo person juridik ose subjekt që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore.

f) Termit “ndërmarrje e një shteti kontraktues” dhe “ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues” nënkuptojnë, përkatësisht, një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i një shteti kontraktues dhe një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i shtetit tjetër kontraktues.

g) Termi “trafik ndërkombëtar” nënkupton çdo transport me anije ose avion të operuar nga një ndërmarrje që e ka vendin e saj të menaxhimit efektiv në një shtet kontraktues, përveç kur anija ose avioni operojnë vetëm midis vendndodhjeve në shtetin tjetër kontraktues.

h) Termi “autoritet kompetent” nënkupton:

i) në rastin e Shqipërisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të autorizuar nga Ministria e Financave ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj;

ii) në rastin e Singaporit, Ministrin e Financave ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

i) Termi “shtetas” nënkupton:

i) çdo individ që ka kombësinë ose shtetësinë e atij shteti kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që e marrin statusin si të tillë nga ligjet në fuqi në një shtet kontraktues.

2. Për qëllimet e neneve 10, 11 dhe 12, një subjekt i besuar që i nënshtrohet tatimit në një shtet kontraktues në lidhje me dividendët, interesin ose tarifën e licencave, konsiderohet të jetë pronari përfutës i atij interesi ose dividendëve apo tarifave të licencave.

3. Për sa i përket zbatimit të marrëveshjes në çdo kohë nga një shtet kontraktues, çdo term i papërkufizuar në të, për sa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka pasur në atë kohë sipas ligjit të atij shteti, për qëllime tatimore për të cilat zbatohet kjo marrëveshje, ku çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij shteti ka përparësi mbi një kuptim të dhënë termit sipas ligjeve të tjera të atij shteti.

Neni 4 Rezidenti

1. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje, termi “rezident i një shteti kontraktues”, nënkupton çdo person, i cili, sipas ligjeve të atij shteti, u nënshtrohet tatimeve përkatëse për shkak të vendbanimit, vendqëndrimit, vendit të menaxhimit, vendit të regjistrimit ose çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe gjithashtu përfshin atë shtet dhe çdo nënndarje politike ose autoritet lokal, apo organ ligjor të tij.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 2, një individ është rezident në të dyja shtetet kontraktuese, statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit, në të cilin ka një banesë të përhershme në dispozicion; nëse ka një banesë të përhershme në dispozicion në të dyja shtetet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetikë);

b) nëse shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetikë nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në asnjë shtet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit, në të cilin ka një vendqëndrim të zakonshëm;

c) nëse ka vendqëndrim të zakonshëm në të dyja shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit, shtetas i të cilit ai është;

d) në çdo rast tjetër, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese e zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dyja shteteve kontraktuese, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit të tij efektiv. Nëse vendi i menaxhimit efektiv nuk mund të përcaktohet, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese e zgjidhin çështjen me marrëveshje të përbashkët.

Neni 5 Selia e përhershme

1. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend të caktuar biznesi, nëpërmjet të cilit zhvillohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin, në veçanti:

- a) një vend menaxhimi;
- b) një degë;
- c) një zyrë;
- d) një fabrikë;
- e) një punishte; dhe
- f) një minierë, një pus nafte ose gazi, një gurore ose një vend tjetër të nxjerrjes së burimeve natyrore njerëzore.

3. Termi “seli e përhershme”, gjithashtu, përfshin:

a) një shesh ndërtimi, një projekt ndërtimi, montimi ose instalimi apo aktivitete mbikëqyrëse në lidhje me të, por vetëm kur ky shesh, projekt ose aktivitet vazhdon për një periudhë prej më shumë se dymbëdhjetë muaj.

b) dhënie e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës nga një ndërmarrje nëpërmjet punonjësve ose personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm kur aktivitetet e asaj natyre vazhdojnë (për të njëjtin projekt ose që lidhet me të) brenda shtetit tjetër kontraktues për një periudhë ose periudha që përbëjnë më shumë se 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore që fillon ose mbaron në vitin fiskal përkatës.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “seli e përhershme” konsiderohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarje të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje;

c) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllime të blerjes së mallrave ose të mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të vazhdimit, nga ana e ndërmarrjes, të çdo aktiviteti tjetër të një karakteri përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” deri “e”, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të caktuar të biznesit që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person, i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6, vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka dhe ushtron rregullisht në një shtet kontraktues autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, ajo ndërmarrje do të konsiderohet të ketë një seli të përhershme në atë shtet në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, përveç kur aktivitetet e atij personi janë të kufizuara në ato që përmenden në paragrafin 4, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi të caktuar biznesi, nuk do ta bënin këtë të fundit seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk do të konsiderohet të ketë seli të përhershme në një shtet kontraktues vetëm ngaqë zhvillon biznesin në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti me autorizim të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që ata persona të veprojnë sipas rregullave standarde të biznesit të tyre.

7. Thjesht fakti që, një shoqëri, e cila është rezidente e një shteti kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri, e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues, ose që zhvillon biznes në atë shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose ndryshe), nuk tregon që një prej këtyre shoqërive është seli e përhershme e shoqërisë tjetër.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuritë e paluajtshme

1. Të ardhurat që përfitohen nga një rezident i një shteti kontraktues nga pasuritë e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria), që gjenden në shtetin tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” ka kuptimin që ka sipas ligjit të shtetit kontraktues në të cilin ndodhet pasuria në fjalë. Në çdo rast, termi përfshin pasurinë aksesore të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me tokën, uzufuktin e pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa të ndryshueshme ose fikse si: shpërblim për punën, ose të drejtën për të punuar, depozitat minerare, burimet dhe pasuritë e tjera natyrore. Anijet, barkat dhe avionët nuk konsiderohen si pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 zbatohen, gjithashtu, për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, të përdorura për realizimin e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç kur ndërmarrja zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje. Nëse ndërmarrja zhvillon biznes si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të taten në shtetin tjetër, por vetëm për ato që i takojnë asaj selie të përhershme.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një shteti kontraktues zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje, fitimet të cilat mund të pritej të nxirte nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme, sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe që ka marrëdhënie tërësisht të pavarura me ndërmarrjen seli e përhershme e së cilës ajo është, në secilin shtet kontraktues do t'i atribuohen atij vendqëndrimi të përhershëm.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, lejohen si zbritje shpenzimet që janë bërë për qëllime të biznesit të selisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative që do të zbriteshin nëse selia e përhershme do të ishte një ndërmarrje e pavarur, në masën që ato i alokohen në mënyrë të arsyeshme selisë së përhershme, të kryera në shtetin kontraktues ku ndodhet selia e përhershme ose gjetkë.

4. Për sa kohë që është e zakonshme në një shtet kontraktues të përcaktohen fitimet që i atribuohen një selie të përhershme mbi bazën e një ndarjeje të fitimeve totale të ndërmarrjes në pjesë të ndryshme, asgjë në paragrafin 2 nuk përjashton atë shtet kontraktues nga përcaktimi i fitimeve që do të taten nga kjo ndarje siç mund të jetë e zakonshme; megjithatë, metoda e zbatuar për ndarjet do të jetë e tillë që rezultati të jetë në pajtim me parimet në përmbajtje të këtij neni.

5. Asnjë fitim nuk i atribuohet një selie të përhershme për shkak vetëm të blerjes nga ajo seli e përhershme të mallrave për ndërmarrjen.

6. Për qëllime të paragrafëve të mësipërm, fitimet që i atribuohen selisë së përhershme përcaktohen me atë të së njëjtës metodë vit pas viti, për sa kohë që nuk ka arsye të fortë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

7. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave që rregullohen veçmas në nenet e tjera të kësaj marrëveshjeje, dispozitat e atyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Transporti ndërkombëtar

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues nga operimi i anijeve dhe avionëve në trafikun ndërkombëtar janë të tatuueshme vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen, gjithashtu, për fitimet nga pjesëmarrja në një ortakëri, biznes të përbashkët ose agjenci operuese ndërkombëtare.

3. Interesat nga fondet në lidhje me operimin e anijeve ose avionëve në trafik ndërkombëtar konsiderohen si fitime të nxjerra nga operimi i këtyre anijeve dhe avionëve dhe dispozitat e nenit 11 nuk zbatohen në lidhje me këtë interes.

4. Për qëllimet e këtij neni, fitimet e nxjerra nga operimi i anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar përfshijnë:

a) fitimet që rrjedhin nga dhënia me qira e anijeve ose avionëve bosh; dhe

b) fitimet nga përdorimi, mirëmbajtja ose dhënia me qira e kontejnerëve (duke përfshirë trailerat dhe pajisjet përkatëse për transportin e kontejnerëve) të përdorura për transportin e mallrave;

nëse kjo qira, ky përdorim mirëmbajtje ose dhënie me qira, sipas rastit, lidhet me operimin e anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar.

Neni 9

Ndërmarrjet e asociuara

1. Në rastet kur:

a) një ndërmarrje e një shteti kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje shteti kontraktues; ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues dhe një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues;

dhe kur në çdo rast janë caktuar ose vendosur kushtet ndërmjet dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim, që në mungesë të atyre kushteve, do t'i ishte shtuar një prej ndërmarrjeve, por për shkak të atyre kushteve nuk është shtuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të tatóhet përkatësisht.

2. Kur një shtet kontraktues, në pajtim me dispozitat e paragrafit 1, përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij shteti, dhe taton përkatësisht fitimet për të cilat një ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues është tatur në atë shtet tjetër dhe kur autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese bien dakord në konsultime që të gjitha ose një pjesë e fitimeve të përfshira janë fitimet, të cilat do t'i ishin shtuar ndërmarrjes së shtetit të përmendur më parë, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm ndaj sasisë së taksave të vëna në të mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi, duhet t'u kushtohet vëmendje dispozitave.

Neni 10 Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një firmë që është rezidente e një shteti kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të taten gjithashtu në shtetin kontraktues në të cilin është rezidente firma që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i shtetit tjetër kontraktues, taksa e vendosur nuk do të tejkalojë 5 përqind të shumës bruto të dividendëve. Ky paragraf nuk cenon tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet nga të cilat paguhen dividendët.

3. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 2, dividendët që paguhen nga një shoqëri që është rezidente në një shtet kontraktues dhe i paguhen qeverisë ose Këshillit të Ministrave, sipas rastit, të shtetit tjetër kontraktues janë të përjashtuar nga tatimet në shtetin e përmendur më parë.

4. Për qëllimet e paragrafit 3, termi “Qeveria ose Këshilli i Ministrave”:

a) në rastin e Shqipërisë do të thotë Këshilli i Ministrave të Shqipërisë dhe përfshin:

i) Bankën e Shqipërisë; dhe

ii) çdo institucion plotësisht ose kryesisht në varësinë e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë siç mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese.

b) Në rastin e Singaporit do të thotë Qeveria e Singaporit dhe përfshin:

i) Autoritetin Monetar të Singaporit;

ii) Qeverinë e Singaporit, Investment Corporation Pte Ltd;

iii) një organ ligjor; dhe

iv) çdo institucion, plotësisht ose kryesisht, në varësinë e Qeverisë së Singaporit, siç mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese.

5. Termi “dividendë” siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji ose të drejta të tjera, aksionet në miniera, aksionet e themeluesve dhe të drejta të tjera që nuk janë detyrime borxhi, që marrin pjesë në fitime, si dhe të ardhura nga të drejta të tjera të shoqërisë, të cilat i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e shtetit në të cilin firma që bën shpërndarjen është rezidente.

6. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin shoqëria që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur në të dhe që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazën fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose 14.

7. Kur një shoqëri, e cila është rezidente e një shteti kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga shteti tjetër kontraktues, ai shtet tjetër nuk mund të vendosë ndonjë taksë mbi dividendët e paguar nga firma, përveç rasteve kur këta dividendë i paguhen një rezidenti të atij shteti tjetër ose për sa kohë që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët, është efektivisht e lidhur me selinë e përhershme ose një bazë fikse të vendosur në atë shtet tjetër, dhe as nuk do t'i nënshtrojë fitimet e pashpërndara të shoqërisë një taksë mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe nëse dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej fitimeve ose të ardhurave të nxjerra në atë shtet tjetër.

Neni 11 Interesi

1. Interesi i nxjerrë në një shtet kontraktues dhe i paguar një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, ky interes mund të taten në shtetin kontraktues në të cilin ai lind dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është rezident i shtetit tjetër kontraktues, taksa e vendosur nuk do të tejkalojë 5 përqind të shumës bruto të interesit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesi që del në një shtet kontraktues dhe i paguhet qeverisë ose Këshillit të Ministrave, sipas rastit, të shtetit tjetër kontraktues përjashtohet nga tatimi në shtetin e parë.

4. Për qëllimet e paragrafit 3, termi “Qeveria ose Këshilli i Ministrave”:

a) në rastin e Shqipërisë do të thotë Këshilli i Ministrave të Shqipërisë dhe përfshin:

i) Bankën e Shqipërisë; dhe

ii) Çdo institucion plotësisht ose kryesisht në varësinë e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë siç mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese.

b) Në rastin e Singaporit do të thotë Qeveria e Singaporit dhe përfshin:

i) Autoritetin Monetar të Singaporit;

ii) Qeveria e Singaporit, Investment Corporation Pte Ltd;

iii) Një organ ligjor; dhe

iv) Çdo institucion plotësisht ose kryesisht në varësinë e qeverisë së Singaporit siç mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese.

5. Termi “interes” siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i siguruar apo jo me hipotekë dhe nëse ka apo jo të drejtë për të marrë pjesë në fitimet e debitorit, dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë qeveritare dhe të ardhurat nga obligacionet ose dëftesat e borxhit, duke përfshirë fitimet dhe çmimet që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, obligacioneve dhe dëftesave të borxhit. Gjodat për vonesat në pagesa nuk llogariten si interes për qëllimet e këtij neni.

6. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lind interesi, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe detyrimi i borxhit në lidhje me të cilin është paguar interesi, është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose 14.

7. Interesi konsiderohet të lindë në një shtet kontraktues kur pagesi është rezident i atij shteti. Megjithatë, kur një person që paguan interesin, qoftë rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues një seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit mbi të cilën është paguar interesi dhe ky interes përballohet nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë interesi konsiderohet të lindë në shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.

8. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet pagesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e interesit, duke marrë parasysh detyrimin e borxhit për të cilin paguhet, tejkalon shumën, e cila do të ishte rënë dakord nga pagesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, do të zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje.

Neni 12

Tarifat e licencave

1. Tarifat e licencave që lindin në një shtet kontraktues dhe të përfituara në pronësi nga një rezident i shtetit tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto tarifa të licencave mund të taten, gjithashtu, në shtetin kontraktues në të cilin ato lindin dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i tarifave të licencave është rezident i shtetit tjetër kontraktues, taksa e vendosur nuk do të tejkalojë 5 për qind të shumës bruto të tarifave të licencave.

3. Termi “tarifat e licencave”, siç përdoret në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra në lidhje me përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autori të veprës letrare, artistike ose shkencore, duke përfshirë filma kinematografikë dhe filmat ose regjistrimet në shirita

për transmetim radiofonik ose televiziv, çdo program kompjuterik, çdo patentë, markë tregtare, dizenjo ose model, plan, formulë sekrete ose proces ose për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i tarifave të licencave, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lindin tarifat e licencave, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilat paguhen tarifat e licencave, është e lidhur efektivisht me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

5. Tarifat e licencave konsiderohen të lindin në një shtet kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan tarifat e licencave, rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues një seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën është shkaktuar detyrimi për të paguar tarifat e licencave dhe këto tarifa përballohen nga kjo seli e përhershme ose vend fiks, atëherë këto tarifa do të konsiderohen të lindin në shtetin kontraktues në të cilin është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e tarifave të licencave, duke marrë në konsideratë përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin ato janë paguar, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke u kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje.

Neni 13

Fitimet e kapitalit

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një shtetit kontraktues nga tjetërsimi i pronës së paluajtshme të përmendur në nenin 6 dhe të ndodhur në shtetin tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pronës së luajtshme që përbëjnë pjesë të pronës së biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues ose të pronës së luajtshme që i përket një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një shteti kontraktues në shtetin tjetër kontraktues për qëllim të kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, duke përfshirë fitimet nga tjetërsimi i kësaj selie të përhershme (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen) ose të kësaj baze fikse, mund të taten në atë shtet tjetër.

3. Fitimet e një rezidenti nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve të operuar në trafikun ndërkombëtar, ose pronës së luajtshme që i përket operimit të këtyre anijeve, ose avionëve do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

4. Fitimet e përfituara nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve të ndryshme nga aksionet e kuotuar në një bursë të njohur, që marrin më shumë se 50 për qind të vlerës së tyre drejtpërdrejt ose jo nga pasuria e paluajtshme që gjendet në shtetin tjetër kontraktues mund të taten në atë shtet tjetër.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone, të ndryshme nga ajo e përmendur në paragrafët e mësipërm të këtij neni, janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues rezident i të cilit është tjetërsuesi.

Neni 14

Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat që përfitohen nga një individ, i cili është rezident i një shteti kontraktues në lidhje me shërbimet profesionale ose aktivitete të tjera të një karakteri të pavarur, janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç rrethanave të mëposhtme kur këto të ardhura mund të taten edhe në shtetin tjetër kontraktues.

a) nëse ai ka një bazë fikse që i vihet atij rregullisht në dispozicion në shtetin tjetër për qëllim të kryerjes së aktiviteteve të tij, në atë rast vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet asaj baze fikse mund të tatohet në atë shtet tjetër; ose

b) nëse qëndrimi i tij në shtetin tjetër është për një periudhë ose periudha që tajkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës; në atë rast, vetëm ajo sasi të ardhurash që rrjedh nga aktivitetet e tij të kryera në atë shtet tjetër, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose didaktike, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe kontabilistëve.

Neni 15

Të ardhurat nga punësimi

1. Në bazë të dispozitave të nenit 16, 18 dhe 19, rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet, nëse punësimi nuk ushtrohet në shtetin tjetër kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet në këtë mënyrë, ky shpërblim që përftohet atje mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimi i përftuar nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim të ushtruar në shtetin tjetër kontraktues, do të jetë i tatueshëm vetëm në shtetin e përmendur më parë, nëse:

a) marrësi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore, e cila fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës; dhe

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i shtetit tjetër; dhe

c) shpërblimi nuk përballohet nga një vendqëndrim i përhershëm ose bazë fikse, të cilën punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, shpërblimi i përftuar në lidhje me një punësim të ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni të operuar në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues mund të tatohet në atë shtet.

Neni 16

Tarifat e drejtuesve

Tarifat e drejtuesve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtuesve të një shoqërie, e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

Neni 17

Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, të ardhurat që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në rolin e argëtuesit si teatër, film, artist radioje ose televizioni ose muzikant, ose sportist nga aktivitetet personale të këtij personi të ushtruara në këtë mënyrë në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një argëtues ose sportist, nuk përftohen nga subjekti argëtues ose sportisti, por nga një person tjetër, ato të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të tatohen në shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e argëtuesit apo sportistit.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga aktivitetet e ushtruara në një shtet kontraktues nga një artist ose sportist nëse vizita në atë shtet është tërësisht ose

pjesërisht i mbështetur nga fondet publike të një ose të dyja shteteve të shteteve kontraktuese, ose nënndarjet politike, ose autoritetet lokale apo organet ligjore të tij. Në këtë rast, të ardhurat tashmë në shtetin kontraktues në të cilin është rezident artisti ose sportisti.

Neni 18 **Pensionet**

Në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblime të ngjashme të paguara, një rezidenti të një shteti kontraktues duke marrë parasysh punësimin e shkuar, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

Neni 19 **Shërbimi qeveritar**

1(a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, përveç pensioneve të paguara nga një shtet kontraktues ose një nënndarje politike, autoritet lokal ose organ ligjor i tij, një individ në lidhje me shërbimet e kryera për atë shtet ose nënndarje, autoritet ose organ, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto paga ose shpërblime të tjera të ngjashme do të jenë të tatueshme vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë shtet dhe nëse individ është rezident i atij shteti dhe që:

i) është shtetas i atij shteti; ose

ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2(a) Pensionet e paguara nga ose prej fondeve të krijuara nga një shtet kontraktues ose nënndarje politike, autoritet lokal ose organ ligjor i tij për një individ mbi shërbimet e kryera në atë shtet ose nënndarje, autoritet ose organ, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto pensione do të jenë të tatueshme vetëm në shtetin tjetër kontraktues nëse individ është rezident dhe shtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17 dhe 18 do të zbatohen për rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, dhe pensionet, në lidhje me shërbimet e kryera për një biznes të zhvilluar nga një shtet kontraktues ose nënndarjet e tij politike, autoritet lokal ose organ ligjor i tij.

Neni 20 **Studentët dhe stazhierët**

Nëse një student ose stazhier biznesi, i cili është ose ka qenë menjëherë para vizitës në shtetin kontraktues, rezident i shtetit tjetër kontraktues dhe që është i pranishëm në shtetin e parë vetëm për qëllime të edukimit ose trajnimit të tij, asnjë pagesë që merret për qëllimet e mbështetjes ekonomike, edukimit ose trajnimit të tij nuk do të tashmë në atë shtet, me kusht që këto pagesa të lindin nga burime jashtë atij shteti.

Neni 21 **Të ardhura të tjera**

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një shteti kontraktues, kudo që lindin, të patrajtuara në nenet e mësipërme të kësaj marrëveshjeje, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen për të ardhurat e ndryshme nga të ardhurat nga prona e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilat paguhen të ardhurat është efektivisht e lidhur me atë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

3. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2, zërat e të ardhurave të një rezidenti të një shteti kontraktues që nuk trajtohen në nenet e mësipërme të kësaj marrëveshjeje dhe që dalin në shtetin tjetër kontraktues mund të taten, gjithashtu, në atë shtet tjetër.

Neni 22

Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Në Shqipëri, tatimi i dyfishtë shmanget si më poshtë:

a) Nëse një rezident i Shqipërisë përfton të ardhura që, në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, mund të taten në Singapor, Shqipëria lejon si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Singapor.

Megjithatë, kjo zbritje nuk tejkalon atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat që llogariten para se të bëhet zbritja, që i përket të ardhurave që mund të taten në Singapor.

b) Nëse në pajtim me një dispozitë të marrëveshjes, të ardhurat e përftuara nga një rezident i Shqipërisë përjashtohen nga tatimi në Shqipëri, Shqipëria megjithatë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat e mbetura të këtij rezidenti, merr parasysh të ardhurat e përjashtuara.

2. Në Singapor, tatimi i dyfishtë shmanget si më poshtë:

Nëse një rezident i Singaporit përfton të ardhura nga Shqipëria, që, në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje mund të taten në Shqipëri, Singaporit, në pajtim me ligjet e tij në lidhje me tarifën si kredi kundrejt tatimit të Singaporit të tatimit të pagueshëm në çdo vend tjetër përveç Singaporit, lejon tatimin shqiptar të paguar, drejtpërdrejt ose me zbritje, si rezultat i kredisë ndaj tatimit të Singaporit të pagueshëm mbi të ardhurat e atij rezidenti. Nëse këto të ardhura janë dividendë të paguar nga një shoqëri që është rezidente e Shqipërisë një rezidenti të Singaporit që është një shoqëri që ka në pronësi, drejtpërdrejt ose jo, jo më pak se 10 për qind të kapitalit të aksioneve të shoqërisë së parë, kredia merr parasysh tatimin shqiptar të paguar nga ajo shoqëri mbi pjesën e fitimeve nga të cilat paguhet dividendi. Kredia nuk kalon pjesën e tatimit të Singaporit, siç llogaritet para se të jepet kredia, që i përket këtij zëri të të ardhurave.

Neni 23

Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një shteti kontraktues, nuk i nënshtrohen tatimit të shtetit tjetër kontraktues ose çdo kërkesë në lidhje me atë që ndryshon ose është më e rëndë sesa tatimi, dhe kërkesat përkatëse ndaj të cilave shtetasit e atij shteti tjetër nënshtrohen ose mund të nënshtrohen në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, kjo dispozitë zbatohet edhe ndaj personave, të cilët nuk janë rezidentë të një ose të dy shteteve kontraktuese.

2. Tatimi mbi një seli të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues, nuk do të vendoset në mënyrë më pak të favorshme në atë shtet tjetër sesa tatimi i vendosur mbi ndërmarrjet e atij shteti tjetër që zhvillon të njëjtat aktivitete.

3. Asgjë në këtë nen nuk interpretohet si detyruese për një shtet kontraktues për t'u dhënë:

a) rezidentëve të shtetit tjetër kontraktues çdo zbritje financiare personale, lehtësira dhe ulje për qëllime tatimore, të cilat u jep vetëm rezidentëve të vet;

b) shtetasve të shtetit tjetër kontraktues ato zbritje financiare personale, lehtësira dhe reduktime për qëllime tatimore që u jep shtetasve të vet që nuk janë rezidentë të atij shteti ose atyre personave të tjerë që mund të përcaktohen në ligjet tatimore të atij shteti.

4. Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, të paragrafit 8 të nenit 11 ose të paragrafit 6 të nenit 12, interesi, tarifat e licencave dhe disbursime të tjera të paguara nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllim të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të shtetit të përmendur më parë. Po ashtu, çdo borxh i një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllimin e përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të një ndërmarrjeje të tillë, është i zbritshëm sipas të njëjtave kushte t'i ishin kontraktuar një rezidenti të shtetit të parë.

5. Ndërmarrjet e një shteti kontraktues, kapitali i të cilave është në pronësi ose zotërohet tërësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo nga një ose më shumë rezidentë të shtetit tjetër kontraktues, nuk i nënshtrohet asnjë tatimi në shtetin e përmendur më parë dhe asnjë kërkesë në lidhje me të, që është e ndryshme ose më e rëndë se tatimi dhe kërkesat e ngjashme, të cilave mund t'u nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur më parë.

6. Nëse një shtet kontraktues u jep lehtësira nxitëse shtetasve të tij të destinuara për të nxitur zhvillimin ekonomik ose social në pajtim me politikën dhe kriteret e brendshme, nuk interpretohet si diskriminim sipas këtij neni.

7. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për tatime që i nënshtrohen kësaj marrëveshjeje.

Neni 24

Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë

1. Kur një person konsideron se veprimet e një ose të dy shteteve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të në tatim në mospajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, pavarësisht nga mjetet e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i atyre shteteve, ai mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të shtetit kontraktues në të cilin është rezident ose nëse çështja e tij trajtohet në paragrafin 1 të nenit 23, të shtetit kontraktues në të cilin është shtetas. Çështja mund të paraqitet brenda tre vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatimin në mospajtim me dispozitat e marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent, nëse mendon që kundërshtimi është i bazuar dhe nëse nuk është vetë në gjendje për të arritur një zgjidhje të pranueshme, përpiqet të zgjidhë me anë të marrëveshjes së ndërsjellë me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, me qëllim mënjanimin e tatimit që nuk është në pajtim me këtë marrëveshje. Çdo marrëveshje e arritur zbatohet pavarësisht afateve kohore në ligjin e brendshëm të shteteve kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese përpiqen të zgjidhin me anë të marrëveshjes së ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e marrëveshjes. Ata, gjithashtu, mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet, të cilat nuk janë parashikuar në marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin në mënyrë të drejtpërdrejtë, për qëllim të arritjes së një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

Neni 25

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese do të shkëmbejnë informacion përkatës të parashikuar për zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje, për administrimin apo zbatimin e ligjeve të brendshme në lidhje me çfarëdo tatimi dhe njoftimi (me shkrim a me gojë) që bëhet në emër të shteteve kontraktuese a të nënndarjeve të tyre politike, apo autoriteteve lokale, në masën që tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me marrëveshjen. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë nga një shtet kontraktues sipas paragrafit 1, trajtohet si konfidencial në të njëjtën mënyrë si informacioni i përfutur sipas ligjeve të brendshme të atij shteti dhe u deklarohet vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin në lidhje me përcaktimin e ankimeve në lidhje me tatimet që i përkasin paragrafit 1, apo parashikimit të mësipërm. Këta persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta deklarojnë informacionin në procese gjyqësore me dyer të hapura ose në vendime gjyqësore.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk do të interpretohen sikur vendosin mbi një shtet kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në mospajtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të një shteti tjetër kontraktues;

b) të japin informacion që nuk është i përfutueshëm sipas ligjeve ose në punën normale të administrimit në atë ose një shtet tjetër kontraktues;

c) të japin informacion që do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial ose profesional ose proces tregtar apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

4. Nëse kërkohet informacion nga një shtet kontraktues në përputhje me këtë nen, shteti tjetër kontraktues do të përdorë informacionin e vet duke marrë masa për të siguruar informacionin e kërkuar, edhe nëse shtetit tjetër mund të mos i nevojitet ky informacion për qëllimet e tij tatimore. Detyrimi që ka fjalía e mësipërme është subjekt i kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk do të interpretohen të lejojnë një shtet kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit vetëm, sepse ai nuk ka interes të brendshëm në këtë informacion.

5. Dispozitat e paragrafit 3, në asnjë rast nuk do të interpretohen të lejojnë një shtet kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit vetëm se informacioni disponohet nga banka, nga një institucion tjetër financiar, titullar i letrave me vlerë apo person që punon në një agjenci, është menaxheri i besuar, ose nëse informacioni lidhet me interesat e pronësisë së një personi.

Neni 26

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore

Asgjë në këtë marrëveshje nuk cenon privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 27

Hyrja në fuqi

1. Secili shtet kontraktues njofton tjetrin mbi përfundimin e procedurës së kërkuar nga ligji i vet për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit nga këto njoftime dhe dispozitat e saj kanë fuqi:

a) në rastin e Shqipërisë:

Në lidhje me të ardhurat e përfutuara në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik që pason vitin në të cilin hyn në fuqi marrëveshja.

b) në rastin e Singaporit:

Në lidhje me tatimet e vjelshme për çdo vit vlerësimi që fillon më ose pas 1 janarit në vitin e dytë kalendarik pas vitit kur hyn në fuqi marrëveshja.

Neni 28

Përfundimi

Kjo marrëveshje mbetet në fuqi derisa t'i jepet fund nga një palë kontraktuese, secila palë kontraktuese mund ta ndërpresë kontratën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke bërë njoftim me shkrim për përfundimin e saj të paktën gjashtë muaj para fundit të çdo viti kalendarik pas skadimit të një periudhe pesëvjeçare nga data e hyrjes së saj në fuqi. Në një rast të tillë, marrëveshja pushon së qeni në fuqi:

a) në rastin e Shqipërisë:

Në lidhje me të ardhurat e përfutuara në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik që pason vitin në të cilin bëhet njoftimi për përfundimin e marrëveshjes.

b) në rastin e Singaporit:

Në lidhje me tatimet e vjelshme për çdo vit vlerësimi që fillon më ose pas 1 janarit në vitin e dytë kalendarik pas vitit kur bëhet njoftimi.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Nju-Jork, më 23 nëntor 2010 në gjuhën shqipe dhe angleze, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhjeje ndërmjet teksteve, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Ambasador
Ferit Hoxha**

Përfaqësues i Përhershëm i Republikës së
Shqipërisë në Kombet e Bashkuara

**PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
SINGAPORIT**

**Ambasador
Vanu Gopala Menon**

Përfaqësues i Përhershëm i Singaporit në
Kombet e Bashkuara

PROTOKOLL

Në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Singaporit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për mënjanimin e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, të poshtëshënuarit kanë rënë dakord që dispozitat e mëposhtme do të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes.

Në lidhje me paragrafët 4 të nenit 23:

Për qëllimin e lejimit të zbritjes së një pagese interesi nga një person jashtë një shteti kontraktues një personi tjetër jashtë atij shteti kontraktues, asgjë nuk interpretohet sikur e pengon atë shtet kontraktues nga caktimi i çdo detyrimi për të mbajtur tatimin nga kjo pagesë e interesit.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Nju-Jork më 23 nëntor 2010 në gjuhën shqipe dhe angleze, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhjeje ndërmjet teksteve mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Ambasador
Ferit Hoxha**

Përfaqësues i Përhershëm i Republikës së
Shqipërisë në Kombet e Bashkuara

**PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
SINGAPORIT**

**Ambasador
Vanu Gopala Menon**

Përfaqësues i Përhershëm i Singaporit në
Kombet e Bashkuara

LIGJ
Nr.10 405, datë 24.3.2011

PËR KOMPETENCAT PËR CAKTIMIN E PAGAVE DHE TË SHPËRBLIMEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton kompetencat në fushën e pagave dhe të shpërblimeve të punës në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Kompetencat në caktimin e pagës

Në Republikën e Shqipërisë kanë kompetencë për caktimin e pagës, sipas përkatësisë:

- a) Kuvendi;
- b) Këshilli i Ministrave;
- c) këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, këshilli komunal;
- ç) organet kolegjiale drejtuese të njëjësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore, shoqërive aksionare dhe të institucioneve të tjera publike;
- d) personat e tjerë, juridikë a fizikë, vendas ose të huaj, sipas legjislacionit përkatës.

Neni 3
Kompetencat e Kuvendit

Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, miraton:

- a) pagën e Presidentit;
- b) raportet e pagave të funksionarëve të lartë shtetërorë, të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj;
- c) strukturën e pagës për nëpunësit/punonjësit e administratës publike, qendrore dhe vendore.

Neni 4
Kompetencat e Këshillit të Ministrave

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe të Ministrit të Financave, miraton pagën minimale mujore, në shkallë vendi, e cila është e detyrueshme të zbatohet nga çdo punëdhënës, vendas ose i huaj.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon Departamentin e Administratës Publike dhe të Ministrit të Financave miraton:

- a) pagat e shpërblimet e drejtuesve të institucioneve qendrore që nuk përfshihen në nenin 3 të këtij ligji dhe pagat e personave të tjerë, të barazuar me ta, sipas nenit 3;
- b) strukturën e pagave për nëpunësit/punonjësit e administratës publike, qendrore dhe vendore, për të cilët kjo strukturë nuk është e shprehur në ligjet specifike;

c) numrin e klasave, nivelet e pagave, të shtesave mbi pagë dhe të shpërblimeve për nëpunësit/punonjësit e administratës publike, qendrore dhe vendore;

ç) aktet nënligjore për rregullat dhe kriteret për përcaktimin e masës së shpërblimeve për rezultate të mira në fund të vitit, për shpërblimin shtesë për punën e kryer mbi kohën normale të punës, në ditët e festave zyrtare e të pushimit javor dhe për raste të tjera, të parashikuara në Kodin e Punës dhe në ligje të tjera të veçanta, për nëpunësit/punonjësit e administratës publike, qendrore dhe vendore;

d) klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe të kufijve maksimalë e minimalë të pagave për funksionarët e zgjedhur, të emëruar, për nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë në organet e qeverisjes vendore.

3. Këshilli i Ministrave, sipas rastit, me propozimin e Ministrit të Financave, miraton shpërblimin e anëtarëve të këshillave, të bordeve ose të komisioneve të institucioneve qendrore, kur legjislacioni përkatës parashikon krijimin e një këshilli ose të bordit drejtues me të drejtë pagese në këto institucione.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, miraton kufirin maksimal të pagës dhe të shpërblimit të titullarit të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare me kapital mbi 50 për qind shtetëror, si dhe kufirin e shpërblimit të anëtarëve të këshillave a të bordeve drejtuese të tyre.

Neni 5

Kompetencat e këshillave të qeverisjes vendore

Këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, këshilli komunal, sipas përkatësisë, miratojnë:

a) pagën për çdo funksion të zgjedhur, të emëruar, për nëpunësit dhe punonjësit e tjerë, brenda kufijve të pagave për çdo grup të njësive të qeverisjes vendore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave;

b) njehsimin në pagë, në përputhje me klasifikimin e funksioneve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, për çdo funksion të ri që vendos të krijojë;

c) shpërblimin mujor të këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave, në masën deri në 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të këshillit të qarkut, të kryetarit të bashkisë dhe të kryetarit të komunës;

ç) shpërblime të personave, nga burimet e veta financiare, të cilët caktohen në komitete, borde, këshilla, komisione, e të tjera të kësaj natyre, që ngrihen me vendim të këshillit përkatës;

d) pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të rasteve kur me ligj të veçantë është parashikuar ndryshe.

Neni 6

Kompetencat e organeve kolegjiale

1. Organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë:

a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës;

b) masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës.

2. Për ndërmarrjet shtetërore, veprimtaria e të cilave është me humbje, ose që subvencionohen nga shteti, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përkatës dhe të Ministrit të Financave, miraton, me akte të veçanta, nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të punonjësve të tyre.

Neni 7
Dispozita kalimtare

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e parashikuara brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 8
Dispozita shfuqizuese

Ligji nr. 8487, datë 8.7.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6969, datë 12.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr.93, datë 7.4.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 228, DATË 29.1.2009 “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE
TË PUNËS TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:


I. Lidhja nr. 1 e vendimit të Kuvendit nr. 228, datë 29.1.2009 ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 228, datë 29.1.2009 ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

STRUKTURA E INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE



**ORGANIKA DHE NUMRI I PUNONJËSVE TË INSPEKTORATIT TË LARTË
TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**

(Struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës janë miratuar sipas vendimit të Kuvendit nr. 228, datë 29.1.2009)

Funksioni		Nr. i punonjësve/kategoria/klasa
I. Inspektor i Përgjithshëm	1	Ligji nr.9584, neni 4
Sekretar i Inspektorit të Përgjithshëm	1	VKM nr.616 (2010)
II. Sekretar i Përgjithshëm	1	I-b VKM nr.616
III. Inspektorë të Lartë		
Inspektorë	11	II-a + 10 000 lekë
Ndihmësinpektorë	11	II-b + 10 000 lekë
IV. Drejtoria Juridike dhe e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse		
Drejtor	1	II-b VKM nr.616
IV/1. Sektori i Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	2	III-b
IV/2. Sektori Juridik		
Specialistë	2	III-b
V. Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse		
Drejtor	1	II-b
V/1. Sektori i Teknologjisë së Informacionit		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialist	1	III-b
V/2. Sektori i Protokoll - Arkivit		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	2	III-b

V/3. Sektori i Financë - Buxhetit

Specialist finance	1	IV-a
Specialist buxheti	1	III-b
Magaznier	1	V VKM nr.621(2010)
Shofer	1	IV VKM nr.621(2010)
Receptionist	1	III VKM nr.621(2010)
Pastruese	2	I VKM nr.621(2010)

Totali

44 punonjës

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2010

Kuvendi i Shqipërisë, duke konsideruar se:

- procesi zgjedhor është rezultat i kontributit të përbashkët pozitiv dhe ligjor të të gjithë aktorëve, partive politike dhe shoqërisë civile në vend;
- zgjedhjet e lira, të drejta dhe të ndershme përbëjnë themelin e shtetit dhe të demokracisë;
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka një rol të rëndësishëm në organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve, por ky rol duhet të ketë mbështetjen dhe rolin aktiv të forcave politike, medias dhe shoqërisë civile për realizimin e detyrës së përbashkët për zgjedhje të lira, të drejta, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- forcat politike duhet të kenë dhe të demonstrojnë aktivisht vullnetin e plotë politik për mbajtjen dhe realizimin e zgjedhjeve më të mira që ka zhvilluar Shqipëria pas viteve 90;

Konstaton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2010:

- ka zhvilluar veprimtarinë e tij në përputhje me përcaktimet legjislative dhe në kuadrin e një viti jozgjedhor;
- ka zhvilluar veprimtarinë për përgatitjen e zgjedhjeve vendore të radhës për vitin 2011, me qëllim realizimin e tyre në përmbushje të plotë të standardeve ndërkombëtare;
- ka miratuar/rishikuar aktet nënligjore, në kompetencë të KQZ-së, në përputhje me rekomandimet e dhëna në raportin përfundimtar të zgjedhjeve nga OSBE/ODIHR-i dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë;
- ka nxitur një klimë të përshtatshme bashkëpunimi dhe konsensusi brenda anëtarësisë së KQZ-së, me qëllim rritjen e fizionomisë dhe vendimmarrjes teknike të saj.

Kuvendi kërkon nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2011:

- të mundësojë, për sa i përket aspekteve zgjedhore, të cilat me ligj janë kompetencë e KQZ-së, realizimin e zgjedhjeve vendore të datës 8 maj 2011 në mënyrë të lirë, të drejtë, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- të vijojë dhe të konsolidojë më tej rolin profesional dhe teknik të tij, të vlerësuar ndër vite me nota maksimale nga raportet e OSBE/ODIHR-it;
- të mundësojë realizimin e një klime bashkëpunuese dhe konsensusi brenda anëtarësisë së KQZ-së, si dhe në marrëdhëniet me forcat politike, me qëllimin përfundimtar që t'i shërbejë detyrës ligjore, kompetencës dhe misionit të KQZ-së për realizimin e zgjedhjeve të 8 majit 2011, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- të fillojë konsultim të gjerë me aktorët politikë dhe shoqërinë civile për vendosjen e teknologjive moderne të votimit në zgjedhje në të ardhmen;

- të vijoje forcimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare në funksion të përmirësimit të standardeve zgjedhore, si dhe vijimin e ndërgjegjësimit të zgjedhësve për ushtrimin e së drejtës së votës, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare.

7 prill 2011

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

KËRKESË
Nr.1128/2, datë 18.3.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkozet-Durrës-Shkozet (zona e Kënetës).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.872, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, si dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin e listës emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët për të cilët në kolonën “Shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP”, dë të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 17 989 200 (shtatëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR “SISTEMIM, ASFALTIM, RRUGA SHKOZET DURRËS, NË ZONËN E KËNETËS”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi për njësi	Vlera (lekë)	Shënime
1	Bektash	Fejzi	Agalliu	8517	156/25	Arë	2370	3600	8532000	Konfirmim nga ZVRPP
2	Milena	Kostandin	Nishku	8517	158/34	Arë	396	3600	1425600	Konfirmim nga ZVRPP
3	Besnik	Dine	Arreza	8517	158/33	Arë	396	3600	1425600	Konfirmim nga ZVRPP
4	Rexhep	Avdulla	Rexhmataj	8517	158/44	Arë	396	3600	1425600	Konfirmim nga ZVRPP
5	Shasho	Xhaferr	Çollaku	8517	158/43	Arë	248	3600	892800	Konfirmim nga ZVRPP
6	Ylli		Bala	8517	158/38	Arë	130	3600	468000	Konfirmim nga ZVRPP
7	Imer	Osman	Gjana	8517	158/39	Arë	130	3600	468000	Konfirmim nga ZVRPP
8	Lulzim		Danushi	8517	171/235	Arë	45	3600	162000	Konfirmim nga ZVRPP
9	Lefter	Mevlan	Gumeni	8517	171/236	Arë	45	3600	162000	Konfirmim nga ZVRPP
10	Myrteza	Urim	Cenolli	8517	171/112	Arë	115	3600	414000	Konfirmim nga ZVRPP
11	Petraç	Mihal	Krekas	8517	171/113	Arë	96	3600	345600	Konfirmim nga ZVRPP
12	Spiro		Roci	8517	171/260	Arë	58	3600	208800	Konfirmim nga ZVRPP
13	Adile		Roci	8517	171/261	Arë	58	3600	208800	Konfirmim nga ZVRPP
14	Agim		Roci	8517	171/262	Arë	58	3600	208800	Konfirmim nga ZVRPP
15	Edmond		Roci+Bp	8517	171/254	Arë	47	3600	169200	Konfirmim nga ZVRPP
16	Edmond		Kurti	8517	171/255	Arë	29	3600	104400	Konfirmim nga ZVRPP
17	Neki	Fazli	Zeria	8517	172/128	Arë	190	3600	684000	Konfirmim nga ZVRPP
18	Fondacioni	“Liahona”		8517	172/129	Arë	190	3600	684000	Konfirmim nga ZVRPP
	Shuma						4997		17989200	

KËRKESË

Shtetasi Damian Karagjozi, i biri i Agronit dhe i Naxhies, i datëlindjes 16.3.1987, lindur dhe banues në Gjirokastrë, kërkon shpalljen të zhdukur të hallës së tij, shtetases Neriman Karagjozi.

KËRKUESI
Damian Karagjozi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 20.4.2011
Doli nga shtypi më 22.4.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 28 lekë